




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MPB kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Çështje tjetër**

- 1 Transaksionet nga kategoritë e investimeve kapitale dhe pasuritë të cilat kanë qenë të klasifikuara (niveli i kufizuar) nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto pagesa auditohen ndaras, për çështjet eventuale përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse. Në anën tjetër, kontratat dhe pagesat e klasifikuara (konfidencial dhe sekret) nuk janë audituar dhe nuk janë pjesë e këtij raporti.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MPB-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat ku janë identifikuar mangësi dhe kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë pagesat e punonjësve në mungesë të evidencave të vijueshmërisë në punë, gabimet në shpalosjen e detyrimeve kontigjente dhe llogarive të arkëtueshme.

Ndërsa, sa i përket mospajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, ministria duhet të i forcoj edhe më tej kontrollet sa i përket vonesave në realizimin e punimeve, mbajtjen e pozitave në mospërputhje me gradat e fituara, mos respektimin e dispozitave me rastin e suspendimeve dhe menaxhimit të procesit të inventarizimit të pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre tre (3) rekomandime të reja, tre (3) të përsëritura, dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 118,561,739€ prej tyre ishin shpenzuar 118,547,111€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 11,381 punonjës, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 10,372. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

#### Çështja B1 - Kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë

##### Gjetja

Neni 9, paragrafi 2 dhe 3 i Rregullores (QRK) Nr.07/2022 Për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik përcakton se: "Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. Mos regjistrimi në evidencat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mos prezencë në punë".

Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr.06/39 i dt. 22.07.2015, ish MAP, ishte e obliguar t'i sistemoj 20 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritetit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kishin punuar asnjëherë për ministrinë që nga nënshkrimi i akt emërimeve të tyre. Rrjedhimisht, sipas konfirmimeve nga zyrtarët relevant, për të njëjtit nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Vlera e pagesave të realizuara për këta punonjës për vitin 2023 ishte 108,794€.

Kjo dukuri vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerri masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

##### Ndikimi

Pagesat e pagave në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit të ministrisë.

##### Rekomandimi B1

Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B2 - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara

##### Gjetja

Neni 38, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 02/2023 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës (PK), përcakton se: me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë secili zyrtar i Policisë mund të caktohet në një vend të punës apo transferohet prej një vendi në vendin tjetër të punës nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për atë vend të punës, pa marrë parasysh nivelin, pozitën apo gradën. Udhëzimi Administrativ nr.02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policor përcakton kriteret që duhet t'i plotësoj secili Zyrtar Policor për pjesëmarrje në gradim dhe procesin e testimit që duhet t'i nënshtrohet për të marrë gradën e caktuar. Struktura organizative e Policisë së Kosovës përcakton gradën e kërkuar për secilën pozitë të punës.

Një numër i stafit policor vazhdon të jetë i sistemuar në pozita të punës pa e plotësuar kriterin e gradës që e kërkon ajo pozitë sipas strukturës organizative. Sipas të dhënave nga njësia e personelit, 185 zyrtar policor vazhdojnë të mbeten të sistemuar në pozita ku kërkohet gradë më e lartë se sa grada që aktualisht e kishin arritur të punësuarit përmes procesit të rregullt të gradimit. Në raport me vitin paraprak numri i zyrtarëve është rritur nga 133 në 185.

Policia e Kosovës, në vitin 2024 kishte filluar me procesin e gradimit për pozitën rreshter, vonesat e të cilit ishin ndikuar nga struktura organizative e policisë e cila ka qenë në plotësim-ndryshim dhe situata e krijuar në vend.

**Ndikimi** Sistemimi i stafit në pozita që nuk janë në përputhje me gradën adekuate mund të ndikojë që pozitën e punës të ushtrohen nga persona me mungesë të kompetencës profesionale.

**Rekomandimi B2** Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A1 - Kompensimi jo në përputhje me dispozitat në fuqi**

**Gjetja** Neni 78, paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ 02/2023 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, përcakton që: "Suspendimi nga puna mund të zgjasë më së shumti 6 muaj. Pas kësaj periudhe punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpusë kontratën e punës. Gjatë kësaj periudhe kohore të punësuarit i takon kompensimi në pagë në lartësi prej 50% të pagës".

Numri i zyrtarëve të suspenduar, të cilët vazhdojnë të kompensohen përtej periudhës së lejuar me dispozitat në fuqi, sipas konfirmimeve të zyrtarëve përkatës, deri në fund të vitit 2023 ishte 144. Kjo është verifikuar me rastin e suspendimit të përkohshëm të zyrtarit policor, bazuar në vendimin e datës 17.03.2022, i cili ishte kompensuar me pagë me lartësi prej 50 % përtej tejkallimit të periudhës së lejuar prej 6 muajve. Për më tej, janë verifikuar edhe nëntë (9) raste tjera nga lista e pagave krahasuar me listën e të suspenduarve.

Kjo kishte ndodhur pasi që Policia e Kosovës ende nuk kishte pranuar rekomandimin për ndërprerje të suspendimit të përkohshëm nga Inspektorati Policor i Kosovës. Për më shumë, nuk ishin marrë masa për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me raste të tilla.

**Ndikimi** Mos respektimi i rregulloreve në fuqi për kompensimin e pagesave për suspendim të përkohshëm më gjatë se gjashtë (6) muaj, mund të sjellë kosto shtesë për buxhetin e Policisë së Kosovës, duke ulur disponueshmërinë e fondeve për nevojat tjera buxhetore.

**Rekomandimi A1** Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që të zbatohen me saktësi kufizimet kohore dhe kompensimet në pagë sipas

rregulloreve në fuqi, duke shmangur shkeljet dhe moskuptimet e mundshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 53,942,564€, prej tyre ishin shpenzuar 40,979,522€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe renovimin e objekteve, blerjen e automjeteve, furnizim me licenca për programe, etj.

### Çështja B3 - Vonesa në realizimin e punimeve

#### Gjetja

Neni 61.19 i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), përcakton se menaxheri i kontratës, ndër të tjera, do të menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë dhe të sigurojë se Operatori Ekonomik (OE) kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në pesë (5) raste kemi kemi identifikuar që punimet nuk ishin realizuar sipas kushteve kontraktuale (katër prej tyre, të evidentuara në raportin e auditimit 2022). Rastet e identifikuar si dhe ditët e vonesave janë llogaritur sipas kontratës/projektit deri në dhjetor 2023.

- Projekti "Ndërtimi i objektit të menzës në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike" në vlerë 1,064,337€, me afat përfundimi deri në 30.11.2023. Punët e përfunduara deri në fund të vitit ishin 62%;
- Projekti "Ndërtimi i shkollës profesionale në Komoran-Drenas" në vlerë 2,845,381€, me afat përfundimi deri në shtator 2021. Vonesat ishin 27 muaj, përderisa projekti nuk ishte përmbyllë as për vitin 2023. Realizimi i kontratës ishte i njëjtë si në vitin paraprak, 73%;
- Projekti "Ndërtimi i shkollës fillore në Pejë" në vlerë 1,977,964€, me afat përfundimi deri në mars 2020. Vonesat ishin 45 muaj, përderisa projekti nuk ishte përmbyllë as për vitin 2023. Realizimi i kontratës ishte 89%;
- Projekti "Adaptimi-Renovimi i ish Tribunës për Departamentin e Prodhimit të Dokumenteve ARC-MPB" në vlerë 1,454,450€, me afat përfundimi deri në dhjetor 2022. Vonesat ishin 12 muaj, përderisa projekti nuk ishte përmbyllë as për vitin 2023. Realizimi i kontratës ishte 87%; dhe
- Projekti "Studimi i Fizibilitetit për Spitalin e Prishtinës" në vlerë 650,000€, me afat përfundimi deri në mars 2020. Vonesat ishin 44 muaj, përderisa projekti nuk ishte përmbyllë as për vitin 2023. Realizimi i kontratës ishte i njëjtë si në vitin paraprak, 66%.

Për më tepër, ishin hasur vonesa në realizim të punimeve edhe në katër (4)<sup>s</sup> projekte të përmbyllura në vitin 2023. Vonesat ishin nga dy (2) muaj deri në shtatë (7) vjet.

Shkaqet e vonesave kryesisht ishin problemet procedurale dhe pronësore, si dhe vonesat në aprovimin e kërkesave për punët shtesë për shkak të mungesës buxhetore.

#### Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të ngarkojnë buxhetin e vitit pasues. Po ashtu, këto vonesa ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në arritjen e objektivave të ministrisë.

**Rekomandimi B3** Ministri duhet të siguroj se para inicimit të aktiviteteve të prokurimit për projekte paraprakisht të kryhen analizat e duhura buxhetore në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike duke përfshirë edhe procesin e shpronësimeve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 147,495,258€, pasurive jo kapitale 7,138,590€ si dhe e stoqeve 8,802,223€. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

#### Çështja A2 - Mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare

**Gjetja** Neni 19 i rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se çdo fund vit duhet të behet inventarizimi, nga komisioni për inventarizim i cili ndër të tjera është përgjegjës edhe për: verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare dhe krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Më tej, neni 21 përcakton përgjegjësitë e komisionit për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer pas datës së raportimit të PFV-ve. Rrjedhimisht, nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive. Raportet e inventarizimit të hartuara nga komisionet ishin kryer pas datës së përgatitjes së PFV, për MPB me datë 19.04.2024 dhe PK me datë 12.02.2024. Në anën tjetër, ministria dhe njësitë vartëse të saj nuk kishin formuar komisionet e vlerësimit të pasurisë për vitin 2023.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të ministrisë lidhur me pajtueshmërinë ligjore, konkretisht mos përmbushjes së afateve për përfundimin e raporteve me kohë nga ana e komisioneve.

**Ndikimi** Vonesat në procesin e inventarizimit, kanë ndikuar në mos harmonizimin e gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, duke mos ofruar siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

**Rekomandimi A2** Ministri duhet që nëpërmjet zyrtarëve relevant të sigurojë se komisionet e inventarizimit hartojnë raportet e inventarizimit me kohë, me qëllim të krahasimit të raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, të bëhet vlerësimi i pasurive me qëllim të pasqyrimin të saktë dhe të drejtë të gjendjes së regjistrave të pasurisë së ministrisë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.4 Të arkëtueshmet

Vlera e paraqitur në PFV e llogarive të arkëtueshme është 23,159,963€. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

### Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

#### Gjetja

Neni 16 i Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar përcakton që: “Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave”.

Llogaritë e arkëtueshme në PFV ishin mbivlerësuar pasi ishin shpalosur edhe gjordat me vendime të gjykatave. Në dy (2) raste, Policia e Kosovës kishte lëshuar fletëparaqitje për kundërvajtje (pa e precizuar vlerën financiare të gjorbës) duke i proceduar lëndët në Gjykatë. Të njëjtat në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), ishin regjistruar në vlerë financiare në shumë 950€, pas kthimit të vendimit nga gjykata. Në raste të tilla, të hyrat nga këto kundërvajtje nuk arkëtohen nga ana e policisë pasi janë në kompetencë për trajtim dhe vendosje nga ana e gjykatave. Rrjedhimisht, nuk do të duhej të raportoheshin në PFV si llogari e arkëtueshme e PK-së. Sipas konfirmimit të zyrtarëve të PK-së, vlera totale e rasteve të njëjta të prezantuara në PFV për vitin 2023 është 6,550€.

Mungesa e kontrollit të brendshëm për regjistrim dhe raportim të llogarive të arkëtueshme përmes sistemit SIPK, ishte shkak i paraqitjes së dobësive në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

#### Ndikimi

Regjistrimi gabimisht në sistemin (SIPK) i fletëparaqitjeve të cilat janë proceduar në gjykatë kanë ndikuar në shpalosjen jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PFV.

#### Rekomandimi A3

Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të forcoj kontrollet për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të siguroj se rastet e proceduara në gjykatë të mos përfshihen në regjistrin e llogarive të arkëtueshme dhe shpalosjen e drejtë të hyrave në PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.5 Detyrimet kontigjente

Vlera e paraqitur në PFV e detyrimeve kontigjente është 12,758,518€. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

### Çështja C1 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontigjente

**Gjetja** Neni 6 i Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton se “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Vlera e detyrimeve kontigjente e shpalosur në PFV ishte mbivlerësuar për 9,891€. Kjo ishte ndikuar nga mbivlerësimi për 591,944€ pasi në tre (3)<sup>e</sup> raste ishin përfshirë lëndë për të cilat kishte vendim të Gjykatës së Apelit në favor të ministrisë, shpalosje e pasurive kontigjente si detyrime kontigjente si dhe gabimeve në shpalosje të vlerave. Në anën tjetër, ky regjistër ishte nënvlerësuar për 582,053€ për shkak të mos përfshirjes në regjistër të dy (2) rasteve. Përderisa, pasuritë kontigjente në vlerë 203,066€ nuk ishin prezantuar ndaras.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontroleve të dobëta nga ana e zyrës së financave dhe departamentit ligjor të PK-së, lidhur me mbajtjen e evidencave të sakta dhe raportimin e saktë të tyre në PFV.

**Ndikimi** Shpalosja e detyrimeve kontigjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV-ve të mos informohen drejtë dhe saktë.

**Rekomandimi C1** Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës (PK) duhet të sigurojë që detyrimet kontigjente të prezantohen në vlera të sakta si dhe të mbahen evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi                   | Buxheti fillestar  | Buxheti final <sup>7</sup> | 2023 Shpenzimet    | 2022 Shpenzimet    | 2021 Shpenzimet    |
|------------------------------|--------------------|----------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| <b>Burimet e fondeve</b>     | <b>179,768,259</b> | <b>219,807,471</b>         | <b>202,668,133</b> | <b>149,563,945</b> | <b>152,641,683</b> |
| Grante Qeveritare - Buxheti  | 178,877,130        | 218,345,737                | 201,586,333        | 149,061,696        | 151,744,330        |
| Financimi përmes huamarrjes  | 0                  | 78,625                     | 0                  | 0                  | 0                  |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0                  | 391,130                    | 391,130            | 0                  | 230,011            |
| Të hyrat vetanake            | 891,129            | 891,129                    | 677,126            | 499,999            | 663,482            |
| Donacionet e jashtme         | 0                  | 100,850                    | 13,544             | 2,250              | 3,860              |

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 40,039,212€. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i vendimeve të Qeverisë. Në muajin shtator 2023, Zyra për Çështje e Trashëgimisë së TMK-së është shkrirë në kuadër të MPB-së, me ç'rast i është bartur edhe buxheti në vlerë 59,772€.

Në vitin 2023 MPB ka shpenzuar 92% të buxhetit final, me rritje prej 5% në krahasim me vitin 2022.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi   | Buxheti fillestar  | Buxheti final      | 2023 Shpenzimet    | 2022 Shpenzimet    | 2021 Shpenzimet    |
|--|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b> | <b>179,768,259</b> | <b>219,807,471</b> | <b>202,668,133</b> | <b>149,563,945</b> | <b>152,641,683</b> |
| Pagat dhe mëditjet                                     | 96,734,897         | 118,561,740        | 118,547,111        | 91,247,431         | 95,758,690         |
| Mallrat dhe shërbimet                                  | 35,558,000         | 41,093,690         | 38,123,378         | 33,440,224         | 27,315,575         |
| Komunalitë   | 4,950,400          | 4,483,110          | 3,667,840          | 3,455,676          | 4,246,643          |
| Subvencionet dhe transferet                            | 2,141,367          | 1,726,367          | 1,350,281          | 1,204,022          | 1,411,029          |
| Investimet Kapitale                                    | 40,383,595         | 53,942,565         | 40,979,522         | 20,216,592         | 23,909,746         |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 21,826,843€. Rritja ishte ndikuar nga, vendimet e Qeverisë në vlerë prej 28,988,813€, (për mbulimin e mungesës së mjeteve në kategorinë e pagave, dhe harmonizimeve ndarje/kursime buxhetore) dhe vlerës nga donacionet 1,030€, si dhe ishte zbritur si pasojë e transfereve/bartjeve të brendshme buxhetore në vlerë prej 278,036€ dhe vendimeve për kursime buxhetore në fund vit në vlerë prej 6,884,965€. Shpenzimi ishte 100% e buxhetit final;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 5,535,690€. Rritja ishte ndikuar si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë në vlerë 2,881,754€, nga burimet tjera financimi vlerë 78,625€ dhe donacionet vlerë 14,600€, dhe transfereve/bartjeve të brendshme buxhetore në vlerë 2,820,711€, përderisa me vendim për kursime buxhetore në fund vit kishte ulje për 260,000€. Buxheti në këtë kategori ishte shpenzuar 93%;

- Buxheti final i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 467,290€ si rezultat i kursimeve buxhetore sipas vendimit të Qeverisë në vlerë 65,000€ dhe vendimeve për transfere në mes në kategorive ekonomike në vlerë 402,290€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 82%;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 415,000€. Ky ndryshim ishte rezultat i kursimeve buxhetore bazuar në vendimet e Qeverisë në vlerë prej 315,000€, si dhe transfereve buxhetore të brendshme në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë 100,000€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 78%;

- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 13,558,970€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë në vlerë 18,996,890€, zvogëlimit/transfereve të brendshme në vlerë 2,739,287€ dhe kursimeve buxhetore në fund vit 2,698,633€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 76%. Në këtë nivel të ulët të realizimit kanë ndikuar vonesat në inicimin e procedurave, në realizimin e procedurave të prokurimit, gjecjet në realizimin e projekteve, si dhe si pasojë e shqyrtimit të ankesave në OSHP.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga MPB në 2023 ishin në vlerë 72,506,267€. Të hyrat e realizuara rrjedhin nga taksat për regjistrimin e automjeteve, taksat rrugore, taksa për dokumente të udhëtimit, gjoba në trafik dhe taksa tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi                | Buxheti fillestar | Buxheti final     | 2023 Pranimet     | 2022 Pranimet     | 2021 Pranimet     |
|---------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| <b>Totali i të hyrave</b> | <b>76,540,715</b> | <b>76,540,715</b> | <b>72,506,267</b> | <b>69,677,161</b> | <b>66,589,545</b> |
| Të hyrat jo tatimore      | 76,540,715        | 76,540,715        | 72,498,329        | 69,674,022        | 66,586,560        |
| Të hyrat tjera            | 0                 | 0                 | 7,939             | 3,139             | 2,985             |

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të MPB-së ka rezultuar në pesë (5) rekomandime. MPB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, MPB kishte përgatitur edhe Raportin periodik për implementimin e rekomandimeve të dalura.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, një (1) rekomandim ishte zbatuar, një (1) ishte në proces dhe tre (3) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit  | Rekomandimet e vitit 2022  | Veprimet e ndërmarra  | Statusi                 |
|----|--------------------|--|---|-------------------------|
| 1. | Baza për opinion   | Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës (PK) duhet të sigurojë koordinim me avokaturën shtetërore në mënyrë që detyrimet dhe pasuritë kontigjente të prezantohen në vlera të sakta si dhe mbajtjen e evidencave të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.   | Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht për arsye se gjatë vitit 2023 kishte komunikim më të mirë me avokaturën shtetërore, por janë identifikuar raste të mbivlerësimit/nën vlerësimit sa i përket shpalosjeve të detyrimeve kontigjente. | Pjesërisht i zbatuar    |
| 2. | Baza për opinion   | Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar krijimin e kushteve për vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.  | Edhe në vitin 2023 janë identifikuar rastet e njëjta, MPB nuk kishte ndërmarrë veprime.   | Nuk ka filluar zbatimin |
| 3. | Baza për opinion   | Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së dhe Kryeshefin e ARC-së duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Tutje, në konsultim me MFPT, të gjindet një zgjidhje e qëndrueshme konform legjislacionit për angazhimin e zyrtarëve në situata të paparashikuara. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. | Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme në vitin 2023.  | I zbatuar               |
| 4. | Pagat dhe mëditjet | Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.  | Për vitin 2023 kjo çështje vazhdon ende të mbetet e pazgjidhur, numri i pozitave në krahasim me vitin e kaluar ishte rritur.  | Nuk ka filluar zbatimin |

|    |                     |  |   |                        |
|----|---------------------|--|---|------------------------|
| 5. | Investimet kapitale | Ministri duhet të siguroj se para inicimit të aktiviteteve të prokurimit për projekte paraprakisht të kryhen analizat e duhura buxhetore në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike duke përfshirë edhe procesin e shpronësimeve. | Edhe në vitin 2023 janë identifikuar raste të ngjashme. | Nuk ka filluar zbatimi |
|----|---------------------|--|---|------------------------|

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Ajtene Llapashtica, Udhëheqëse e ekipit



Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit



Arnisa Aliu, Anëtare e ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi

|  |           |           |           |
|--|-----------|-----------|-----------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO |           |           |           |
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT                                     |           |           |           |
| NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE        |           |           |           |
| DATA/DATE: - 3 - 06 - 2024                                     |           |           |           |
| Nr. Prof.  | Nr. Prof. | Nr. Prof. | Nr. Prof. |
| 03   | 47        | 706       | 1         |

|   |              |              |              |
|---|--------------|--------------|--------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO      |              |              |              |
| DEVERIA E KOSOVËS/Vlada Kosova/GOVERNMENT OF KOSOVO                 |              |              |              |
| MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/Ministarstvo Unutrasnji Poslova     |              |              |              |
| MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS  |              |              |              |
| Kabineti i Ministrisë / Kabinet Ministros / Cabinet of the Minister |              |              |              |
| Nr. Dik. No.  | Nr. Dik. No. | Nr. Dik. No. | Nr. Dik. No. |
| 0329  | 1            |              |              |
| Data/Date   | Data/Date    | Data/Date    | Data/Date    |
| 31.05.2024  |              |              |              |
| PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA                                     |              |              |              |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrasnji Poslova  
Ministry of Internal Affairs

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Xhejal Svecila

Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Data: 31 Maj 2024, Prishtinë

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>8</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>9</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> 1) Projekti "Përpunimi i fasadës strukturale në hapje në objektin e pallatit të Drejtësisë" në vlerë 275,540€, me afat përfundimi deri 14.02.2023. Përmbyllja e projektit/raporti i pranimi teknik ishte bërë me 22.12.2023. Vonesat ishin 10 muaj; 2) Projekti "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore Gjakovë" në vlerë 1,628.730€, me afat përfundimi deri 14.11.2016. Përmbyllja e projektit/raporti i pranimi teknik ishte bërë me 21.12.2023. Vonesat ishin 86 muaj; 3) Projekti "Demolim, pastrimi dhe mbyllja e hapësirave të ish 21shit dhe ish shtypshkronjës së Rilindjes" në vlerë 81,500€, me afat përfundimi 12.10.2023. Përmbyllja e projektit/raporti i pranimi teknik ishte bërë me 19.12.2023. Vonesat ishin 2 muaj; 4) Projekti "Ndërtimi i garazhës për automjete në kampin Vrella" (PK) në vlerë 81,500€, me afat përfundimi 10.05.2023. Përmbyllja e projektit/raporti i pranimi teknik ishte bërë me 01.08.2023. Vonesat ishin 3 muaj;
- <sup>6</sup> Çështjet e identifikuara janë të Policisë së Kosovës - Mbi vlerësim 1) Unikat Shpk, në vlerë 341,711€; 2) Albes, në vlerë 203,066€ ishte pasuri kontigjente; 3) Alciona Sahara Pejë, në vlerë 47,167€ ishte lëndë e përfunduar me vendim të Gjykatës së Apelit; Nënvlërësimi; 1) Rexhep Gashi (dhe tjerë paditës) në vlerë 574,000€ dhe Nazmi Zejnullahu në vlerë 8,053€ nuk ishin shpalos vlerat te raporti i detyrimeve kontigjente).
- <sup>7</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>8</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>9</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.